

Profeti Muhamed, udhëheqës i mbarë njerëzimit

Askush nuk ka personalitet më të lartë se ai i burrit më të madh në këtë jetë, profetin Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Në të gjitha kohët nuk është dukur si ky personalitet i lartë, i cili bëri ndryshime rrënjësore e të gjëra në historinë e njerëzimit. Qytetërimi që solli profeti vazhdon të ushqejë mbarë botën me njohje dhe dije për shekuj të tërë.

Doktor Maikëll Hart, profesor i matematikës, astronomisë dhe fizikës në Universitetin amerikan si dhe specialist në grupin kozmik amerikan thotë: “E zgjedha Muhamedin të parin në listë dhe shumë njerëz kanë të drejtë të çuditën me këtë zgjedhje. Mirëpo Muhamedi është njeriu i vetëm në histori i cili korri sukses të plotë qoftë nga ana fetare ashtu edhe ajo jetësore. Ai ftoi në Islam dhe e përhapi atë si një ndër fetë më madhështore. Ai ishte udhëheqës politik, ushtarak dhe fetar. Pas kalimit të 13 shekujve nga vdekja e tij, gjurmët dhe ndikimet e Muhamedit vazhdojnë të jenë të forta dhe ringjallëse.” Madhështia e profetit Muhamed duket shumë qartë në ndryshimin e madh që bëri në Gadishullin Arabik duke e nxjerrë atë nga skëtërrat e injorancës dhe paganizmit në dritën e monoteizmit. Imam Aliu (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Allahu e dërgoi atë (profetin Muhamed) kur njerëzit ishin në humbje e në çoroditje, të zhytur në përçarje e shkatërrim, të magjepsur me unin dhe lakminë... Profeti porositi shumë dhe udhëhoqi rrugën duke i ftuar në urtësi e këshillë të mirë.”

Që Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është udhëheqës për mbarë njerëzimin e dëshmon mrekullia e tij e përjetshme, Kur’ani fisnik. Përderisa kjo shpallje është për mbarë njerëzinë, atëherë a nuk është sjellësi, sqaruesi dhe përcjellësi i saj udhëheqës për mbarë njerëzinë? Në Kur’an ka disa ajete që flasin qartë se Profeti Muhamed është i dërguar për të gjithë njerëzit; *siç është ajeti 185 i sures “Bekare”; ajeti 41 i sures “Zumer”; ajeti 170 dhe 174 i sures “Nisa”; ajeti 57 dhe 108 i sures “Junus”;* Po citojmë pesë prej tyre.

1- “Thuaj (o Muhamed): “O njerëz, unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju, i Atij që i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës. Nuk ka zot tjetër të vërtetë veç Atij; Ai jep jetë dhe vdekje, prandaj besoni në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij, Profetin që nuk di shkrim e lexim e që beson në Allahun dhe Fjalët e Tij! Shkoni pas Tij, që të jeni në rrugën e drejtë!” Sure “A’raf”, ajeti 158. Në një transmetim të ardhur nga imam Hasani (paqja qoftë mbi të!), i cili flet për shkakun e zbritjes së këtij ajeti, thuhet: “Disa jahudinj shkuan të profeti Muhamed dhe i thanë: “O Muhamed. Ti je ai që thua se je i Dërguari i Allahut dhe të është shpallur Shpallja njëllor si Musait të birit të Imranit?” Profeti heshti për pak kohë, pastaj tha: “Po. Unë jam zotëria i bijve të Ademit dhe nuk e them për mburrje. Unë jam vula e profetëve, udhëheqësi i të devotshmëve dhe i dërguari i Zotit të botëve.” Ata e pyetën përsëri: “Për kë je dërguar? Për arabët, për joarabët apo për ne.” Atëherë, Allahu zbriti ajetin e parë të mësipërm, që sqaron se ai është i dërguar për mbarë njerëzit. Në ajetin e parë: “**Thuaj (o Muhamed): “O njerëz, unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju”** është urdhri për të gjithë njerëzit: të çdo kohe dhe vendi, të çdo kombi e kombësie, pa dallim race e ngjyre, për ata që ishin të pranishëm në kohën e zbritjes së ajetit dhe për ata që janë dhe do të vijnë. Prandaj, ky është urdhër i Allahut të Madhëruar, që të gjithë njerëzit ta ndjekin profetin Muhamed (paqja dhe

bekimet e Allahut qofshin mbi të!) sepse Ai e dërgoi atë për mbarë njerëzimin. Pa dyshim, që ky është edhe dallimi i profetit Muhamed nga profetët e tjerë: Allahu nuk pati dërguar më parë asnjë profet për mbarë njerëzimin. Po të lexohet me vëmendje Kur'ani, do të shihet se Allahu nuk i është drejtuar asnjë profeti me këtë thënie.

Ajeti përmban edhe disa cilësi të Allahut, ndër to:

- Ai është Sunduesi dhe Pronari i qiejve dhe i Tokës.
- Ai është i Vetëm e i Pashoq.
- Ai është që ringjall të vdekurit dhe i vdes të gjallët.

Po ashtu, ajeti përmban disa nga vetitë e profetit Muhamed:

- Është i pashkolluar.
- Të qëniet e tij besimtar në Allahun dhe në Fjalën e Tij.

Ajeti flet edhe për besimin në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij dhe përfundon me urdhrin për ndjekjen e Profetit. Dihet se besimi është i lidhur me zemrën dhe nuk duket, kurse ndjekja e pasimi janë të dukshme. Nëse të dyja këto bashkohen sjellin udhëzimin e vërtetë.

2- “I lartësuar goftë Ai që i ka zbritur Dalluesin robit të Vet, që të jetë paralajmërues për botët.” Sure “Furkan”, ajeti 1.

Në këtë ajet Allahu i Madhëruar e ka cilësuar profetin Muhamed “rob të Tij”. Në të vërtetë ky është “medalijon nderi” për profetin sepse, profeti është rob i Allahut dhe jo rob i vetes së tij. Ai ka qenë sundues dhe kontrollues i vetes së vet. Ai, që me të vërtetë është rob i Allahut, ai është sundues dhe kontrollues i vetes së vet. I tillë ishte profeti Muhamed dhe për këtë iu shpall Dalluesi (Kur'ani) dhe për këtë është edhe paralajmërues për të gjitha botët. Të qëniet e profetit Muhamed “rob i Allahut” dhe “paralajmërues për botët” tregon se ai nuk ka qenë i veçantë për një popull apo rracë apo vend. Ai është i pastër nga damarët e rracizmit dhe larg prej kombësisë. Ai qëndron mbi arabizmin e joarabizmin. Ai që thotë se Muhamedi është arab, është larguar nga Kur'ani dhe nuk e njeh atë. Profeti ishte njeri, por jo arab e as joarab. Në Kur'an nuk gjejmë që Allahu ta këtë cilësuar profetin si arab por e ka cilësuar si rob dhe të Dërguar të Allahut. Është e ditur që profeti Musai dhe profeti Isai ishin prej bijëve të izraelit mirëpo në Kur'an nuk gjejmë që ata të cilësohen si izraelit. Gjithashtu, as profeti Nuh nuk cilësohet në Kur'an si Sirjanit. Kjo për faktin se profetët janë më të lartit, më fisnikët që t'i kufizojë kombësia, vendi apo krahina. Pa dyshim që profeti ishte njeri si thotë Kur'ani: **“Thuaj, unë jam njeri si ju”** dhe u dërgua për shpëtimin e njerëzisë. Sheriati i tij është për të gjithë njerëzit dhe nuk është i veçantë për një komb, si p.sh., sheriati jahudi. Sheriati i tij nuk është as lindor e as perëndimor, por është mbarëbotëror.

3- “Ky Kuran më është shpallur, në mënyrë që nëpërmjet tij t’ju tërheq vërejtjen juve dhe kujtdo që i përcillet...” Sure “En’am”, ajeti 19.

Ky Kur'an që nuk mund të jetë krijimtari e mendjes njerëzore. Ky Kur'an i cili përmban dëshmi të shumta rreth mrekullisë së tij ku fjalët e tij janë mrekulli kuptimet e tij janë mrekulli. Ky Kur'an që sqaron çdo gjë, është i përherëshëm deri në ditën e fundit të kësaj jete. Ky ajet konstaton se Profeti Muhamed është dërguar për të gjithë ata që u mbrrin Kur'ani. Kjo përfshin të gjithë të gjallët deri në ditën e fundit të kësaj bote. Në disa hadithe lexojmë se kuptimi i përcjelljes së Kur'anit nuk është vetëm me mbërritjen e tekstit original, por ky kuptim përfshin edhe përkthimin e tij në gjuhët e popujve. E kanë pyetur imam Sadikun (paqja qoftë mbi të!) për kuptimin e këtij ajeti dhe ai është përgjigjur: “Me të gjitha gjuhët”

4- “Ne të kemi dërguar ty (o Muhamed) vetëm si sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues për të gjithë njerëzimin, por shumica e njerëzve nuk dinë.” Tesijrul Burhan, fundi i komentimit të ajetit në fjalë. Tefsijri Nuru Thakalejn, vëll. 1, f. 707.

Ky ajet flet për përgjithshmërinë e mesazhit të profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe të qënurit e tij profet për të gjithë njerëzit. Në një hadith të transmetuar nga ibn Abbasi, të cilin e përmendin komentuesit për këtë ajet, profeti Muhamed ka thënë: **“Më janë dhënë pesë dhe nuk e them për krenari. Jam dërguar për të kuqtë dhe të zinjët. Toka më është bërë mua vend pastrimi dhe vendfalje. Janë lejuar për mua, el mugannem, të cilat nuk kaqë qenë të lejuara për askënd para meje. Kam triumfuar me ru'abin i cili ecën para meje si muajt e vitit dhe më është dhënë shefati që do ta zbatoj për ymmetin tim, në ditën e Kiametit.”** Tefsijri “Mexhmaul Bejan”, vëll. 8, f. 391.

5- Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët.” Sure “Enbija”, ajeti 107.

Ky ajet e dëshmon dhe përforcon akoma më shumë të qënurit e profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i Dërguar për mbarë njerëzinë. Dihet se mëshira është prej cilësive të Allahut dhe përfshin çdo gjë. Ky cilësim i profetit me cilësinë e mëshirës pa dyshim që është argumentues se ai është më i larti dhe më fisniku i profetëve. Mëshira e tij në këtë jetë përfshin të gjithë njerëzit, qofshin besimtarë apo jobesimtarë. Kjo për faktin se ai solli dhe përhap fenë shpëtuese për mbarë njerëzimin. Nëse gjenden njerëz që nuk përfitojnë prej kësaj feje kjo ka lidhje me vetë ata njerëz dhe nuk e cënon përgjithshmërinë e mëshirës. Kjo është njësoj sikur të themelohet një spital i pajisur me të gjitha aparaturat për shërimin e sëmundjeve të ndryshme ku në të ka doktora specialistë dhe të aftë, ka ilaçe të ndryshme dhe dyert e këtij spitali janë të hapura për të gjithë njerëzit pa dallim. Vallë, a nuk është ky spital mëshirë për të gjithë njerëzit? Nëse disa njerëz nuk shkojnë në të përshkak të kokforcisë së tyre, kjo nuk ndikon në të qenit e këtij spitali i përgjithshëm. Fraza “lil alemijne” për botët, ka kuptim të gjërë dhe i përfshin të gjithë njerëzit, në çdo koë dhe në çdo vend. Si pasojë, këtë ajet e konsiderojnë tregues dhe argumentues së vulës së profecisë me profetin Muhamed, sepse prania e tij është mëshirë dhe model për të gjithë njerëzit deri në Ditën e Kiametit. Në disa transmetime thuhet se kjo mëshirë përfshin edhe melekët. Është transmetuar nga profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) se kur i ka zbritur ky ajet e ka pyetur Xhebrailin: **“A do të të kapë ty kjo mëshirë? Xhebraili i ka thënë: “Po. Unë i frikësohesha fundit të çështjes, prandaj të**

besova ty kur Allahu më lavdëroi me thënien e Tij: *inde dhil arshi mekijn*". Tefsijri Mexhmaul Bejan, fundi i ajetit në fjalë.

Në tefsijrin e Kurtubiut thuhet se kuptimi i thënies së Allahut në këtë ajet, "lil alemijne", për botët, është për njerëzit dhe për xhindët, sepse profeti ka qenë i dërguar dhe paralajmërues për njerëzit dhe për xhindët. Ai është vula e profetëve dhe mesazhi i tij është për të gjithë njerëzit..." Xhamiu Ahkamil Kur'anil Kerijm: vëll, 13, f. 6. Në këtë jetë të mbushur me shturje, devijime nga të gjitha anët. Në këtë jetë, ku njerëzit janë të zhytur në pavëmendshëmri, padrejtësi, degjenerim moral, etj. del në pah më së miri kuptimi i të qenit të profetit Muhamed mëshirë për të gjitha botët. A ka mëshirë më të madhe se ai që solli fenë e cila nëse zbatohet dhe praktikohet, do të zhduken të gjitha fatkeqësitë, vështirësitë, devijimet, shturjet... etj?

"Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t'i pranohet dhe ai në Botën Tjetër do të jetë i humbur." Sure "Ali Imran", ajeti 85.

"Allahu është Ai që e ka çuar të Dërguarin e Vet me udhërrëfimin dhe fenë e së Vërtetës, për ta ngritur atë më lart se të gjitha fetë, edhe nëse nuk e pëlqejnë idhujtarët." Sure "Saf", ajeti 9. Një tjetër argument që tregon se Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është udhëheqës për mbarë njerëzinë është edhe përmbajtja e Hytbes së Lamtumirës. Nga fillimi e deri në fund të kësaj Hytbeje profeti Muhamed ka thënë "O ju njerëz", pra i drejtohet të gjithë njerëzve dhe nuk ka thënë "O ju myslimanë" ose "O ju që keni besuar".